

PENSIONISTËT E RUAJNË FOLKLORIN



Nëshfaqjet e 21-të rjonale të këngës, muzikës dhe lojërave të organzuara nga Lidhja e Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë, të gjithë kënduan në skenë dhe në salla, ku në publik ishin mbi 200 pensionistë, të gjithë duartrokiten sikur të donin të thonin se ne jemi të gjithë këtu

Shfaqjet rjonale të këngës, muzikës dhe lojërave janë kulmi i organizimit të pensionistëve në çdo bazë, dhe për shkak të aktiviteteve të tjera, Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë ka fituar status me interes publik si organizata e gjashtë qytetare në vendin tonë. Misioni themelor i këtyre ngjarjeve muzikore është ruajtja e krijimeve folklorike të krijuara ndër shekuj. Në shfaqjet rjonale të këngës, muzikës dhe lojërave edhe këtë vit këndohej e vallëzohej në Shkup, në Strumicë, në Koçan, Krushevë, Gostivar, në Bogdanci, në Tetovë... Të gjithë kënduan të njëjtën këngë dhe të gjithë kërcenin të njëjtën valle, si dikur, dhe kështu do të jetë edhe në të ardhmen! Dëshmia se ky manifestim më masiv i pensionistëve është i rëndësishëm për qytetet dhe qytezat ku u zhvilluan shfaqjet, është prania e pothuajse të gjithë krytarëve të komunave që erdhën përtë parë qytetarët e tyre më të vjetër duke vallëzuar e kënduar.

Atmosfera në të gjitha shfaqjet rjonale të këngëve, muzikës dhe lojërave ishte po aq e mirë sa ishte në 76 vitet e fundit. Këndohej dhe vallëzohej ashtu siç këndohej dhe kërcej në të kaluarën, siç këndonin dhe kér-

cenin dikur disa nga analistë të situatës së sotme dhe njerëz që protestojnë dhe kërkojnë të drejtat e tyre, duke harruar se asgjë nuk ishte kurrë në një ngjyrë, por ishte shumëngjyrëshe dhe në disa ngjyrat, por mbizotëronin e kuqja, e verdha, e bardha... ngjyrat e jetës dhe se gjithmonë kishte bukuria dhe gjëzim, por edhe probleme, dhe këtë duhet ta dimë më së miri ne të rriturit dhe të mos e harrojmë.

Në shfaqjet e 21-të rjonale të këngës, muzikës dhe lojërave të organzuara nga Lidhja e Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë, të gjithë kënduan në skenë dhe në salla, ku në publik ishin mbi 200 pensionistë, të gjithë duartrokiten sikur të donin të thonin se ne jemi të gjithë këtu, jemi të gjithë të bashkuar, pavarësisht nga disa probleme të vogla apo të mëdha apo çështje të pazgjidhura. Sikur donin të thonin se ne e dimë që duhet të ndërtohen shtëpi pleqsh, të mos ikin fëmijët dhe nipërit, të ketë ilaçe më të lira, pensione më të larta, mjekë nëpër fshatra... por edhe ne e dimë që kjo nuk është diçka e re! Se këto janë kërkesa përtë cilat kërkohen zgjidhje bashkërisht, të organzuara me faktë e analiza dhe aty ku duhet, e jo në rrugë e para derës së gabuar, dhe se

duhet të shpresojmë e të punojmë bashkë... Dhe do të ketë rezultatet. Shpresat të çon përpëra, por ajo duhet të mbështetet nga mendja dhe arsyja. Ne duhet të ndjekim rrugën e ndërtuar nga shumë breza pensionistësh në dhjetëra vite, duke u përpjekur ta bëjmë jetën e pensionistit gjithmonë më të mirë, më dinjitoze, më cilësore, më të përbajtur, më të sigurt... Ne ia kemi dalë gjithmonë, herë më shumë, herë më pak, ndonjëherë më shpejt, ndonjëherë më ngadalë, por gjithçka po shkonte përpëra! Këtë e dëshmojnë rezultatet dhe arritjet e shumta që i dinë të gjithë dhe ata që i shohin, por edhe ata që nuk duan t'i shohin!

Kështu ishte në shfaqjet rjonale. Kështu do të jetë edhe në Shfaqjen Republike të Këngëve, Muzikës dhe Lojërave, e cila do të mbahet në qershor të këtij viti, në të cilën do të prezantohen vetëm një pjesë e 53 shoqatave anëtare të Lidhjes, megjithëse sipas punës, përpjekjeve dhe cilësisë së performancave, të gjithë duhet sërisht të marrin pjesë dhe të dëshmojnë se shoqëria dhe bashkëjetesa është dëshmja më e mirë e mbi shtatë dekadave të ekzistencës së organizatës së pensioneve në vendin tonë. (K.S. Andonova)



Mbi 55 vjet anëtar aktiv dhe vullnetar në Kryqin e Kuq

Duke u udhëhequr nga parimet dhe forma lëvizëse e humanizmit dhe solidaritetit, Ljubinko Ristov, i lindur në vitin 1950 në fshatin Josifovo, është vullnetar aktiv dhe anëtar i Kryqit të Kuq për më shumë se 55 vjet. Vullnetarizmin e filloj në vitin 1966 si nxënës në shkollën e mesme, duke u përshtirë në aktivitete rinore në Kryqin e Kuq. Vazhdon anëtarësimin dhe vullnetarizmin si përfaqësues i organizatave themelore të Kryqit të Kuq të formuara sipas vendit të angazhimit të tij profesional në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe të organizatës bazë të Kryqit të Kuq të formuar në bashkësinë urbane "Dame Gruev" kur bëhet edhe anëtar i strukturave drejtuese të organizatës së Kryqit të Kuq. Duke filluar si dhu-

rues i ri gjaku, ai vazhdoi të përkushtohet dhe të investojë me ndërgjegje në aktivitete për promovimin dhe avancimin e dhurimit të gjakut, si dhe në aktivitete të karakterit social-humanitar, me theks të veçantë në kujdesin ndaj të moshuarve dhe në aktivitete për gatishmërinë dhe veprimin e Kryqit të Kuq në rast fatkeqësish.

I shtrirë nga motive altruiste, si dhurues i shquar gjaku me mbi 120 dhurime gjaku, Ljubinko Ristov është shembull pozitiv i një personi që pasqyron vlera të larta etike, humanitare dhe morale, përtë cilat ka marrë një numër të madh falenderimesh dhe mirënjohjesh jubilare në nivel lokal, të qytetit dhe kombëtar nga ana e Kryqit të Kuq. Në Ditën Botërore të Vullnetarizmit, Kryqi



i Kuq i Republikës së Maqedonisë ndau mirënjojje përritje të veçanta dhe merita të veçanta në realizimin e qëllimeve dhe detyrate të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë. Mare Koçovska, Sekretare e Kryqit të Kuq të RMV.

INTERVISTË ME DREJTORIN E KOMPANIËS "DAUTI-KOMERC", XHEMAIL DAUTI



Pensionistët janë një kategori qytetarësh e rëndësishme për ne

Inderuar drejtor Xhemali Dauti, bashkëpunimi i kompanisë "Dauti-Komerc" me Shoqatën e pensionistëve Saraj, e cila është anëtare e Lidhjes së Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë, daton disa vite më parë, dhe së fundi keni bashkëpunim të drejtpërdrejtë me Lidhjen. Ju lutemi na tregoni për bashkëpunimin e kompanisë suaj me pensionistët?

Xhemali Dauti: "Dauti-Komerc", vitet e fundit, në mënyrë sistematike investon mjete në krijimin e një shoqërie të shëndetshme. Në vitin 2022, pavarësisht sfidave të krizave ekonomike, kompania nuk hezitoi të investojë në të mirën e shoqërisë. Ne kemi ofruar mbështetje për projekte të realizuara nga fondacione dhe organizata të ndryshme humanitare, si dhe përmes formave të tjera të ndryshme, në vlerë prej 350.000 euro. Dhe në periudhën e ardhshme, "Dauti-Komerc" mbetet një promotor aktiv i ndryshimeve sociale duke mbështetur projekte zhvillimi dhe duke ofruar mundësi të ndryshme për individë, institucione, organizata, klube sportive, klube pensionishtësh dhe shumë platforma të tjera, me tendencë për të krijuar një zhvillim të qëndrueshmë ekonomik dhe social të vendit tonë.

Në këtë kontekst është edhe bashkëpunimi ynë me pensionistët. "Dauti-Komerc" tash e sa vite ka një bashkëpunim të mirë me Klubin e pensionistëve nga Shoqata e pensionistëve Saraj, por edhe me Lidhjen e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, me të cilën kemi bashkëpunuar së fundmi në realizimin e projektit të tyre me Kryqin e Kuq "Pensionisti Rural". Me mjete të marrë nga Bashkimi Evropian janë blerë pako humanitare, të cilat kompania jonë në marrëveshje me Lidhjen ua ka dorëzuar shoqatave të pensionistëve në vendin tonë. Dhe në të ardhmen do të ofrojmë mbështetje të vazhdueshme për pensionistët në raste të ndryshme si festa fetare dhe të tjera. Ne gjithashtu do të vazhdojmë ta bëjmë këtë duke gjetur forma të reja bashkëpunimi. Pensionistët si kategori qytetarësh janë të rëndësishëm për ne dhe ne përpinqemi t'i trajtojmë dhe t'i ndihmojmë në kufijtë e mundësive tona.

Përvec aktiviteteve humanitare, kompania mbështet edhe projekte të tjera të pensionistëve. "Dauti-Komerc" e ka përkrahur edhe publikimin e edicionit special monografik "Aktivitetet dhe vështrimet 2019-2023" të Lidhjes së Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë. Lidhja shprehet mirënjojje të madhe. Do të ishte mirë që kompanitë e tjera të ndiqnin këtë shembull. (Kalina S. Andonova)